



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Komuna e Lipjanit: datë 17.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 14.01.2025, të parashtruar nga O. E. ANESI SH.P.K. Gazmend Zajmi Nr 36, Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra, me Nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1 nxjerr:

V E N D I M

I Refuzohet, kërkesa për ri-shqyrtim e O.E “ANESI SH.P.K. Gazmend Zajmi Nr 36, Prishtinë

të dt. 14.01.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra, me Nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1: nxjerr:

Mbetet në fuqi Vendimi i AK për shpërblim me kontratë i publikuar me datë: 09.01.2025

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Grup i Operatorëve Ekonomik e O.E ANESI SH.P.K. Gazmend Zajmi Nr 36, Prishtinë ka paraqitur kërkesë për Rishqyrtim, të dt. 16.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Mirëmbajtja e ndriqimit publik në Qytet dhe Fshatra, me nr. të Prok: 613-24-7288-2-1-1, kundër vendimi të Autoritetit Kontraktues **për shpërblim me kontratë**, të datës; 09.01.2025.

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.01.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:
Sa i përket pretendimit të tenderuesit ankues se nuk kapërbush kriterin sipas kërkesës në mardhenie pune një ing siq është kërkuar në dosje te tenderit nuk qëndron për arsye siq edhe ju vet e keni nënvizuar shihet se diploma është me titull: automatikë me ekelektronikë.
Sa i përket pretendimit se tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk e ka sjellë vertetimin e ATK-së siq kërkohet në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit as ky pretendim nuk qëndron për arsye se në dosje të tenderit nuk specifikohet se nëse është në marrveshje duhet të bashkangjitet marrëveshja, ndërsa sa i përket se është në marrëveshje për pagim të borgjit në rastet e tilla ne kemi pasur rast edhe më heret dhe për këtë jemi konsultuar drejt për drejt me ATK dhe na është rekomanduar se nëse na paraqitet një vertetim se një opetar ekonomik është në marrëveshje për pagimin e borgjit të ATK-së atëherë ky duhet të pranohet si i mirëqenë.

Sa përket pretendimit se nuk posedon kamion me vinq nuk qëndron marrveshjen dhe libezen e kësaj pajisje do ti bashkangjiten këtij vendimi për të dëshmuar se ekziston .

Sa i përket pretendimit se ju i keni plotësuar kriteret e njoftimit për kontratë se keni në stafin e juaj ing te elektroteknikës por siq është cekë nuk është drejtimi i automatikës dhe po mundoheni që të krijoni paqartësi duke përdorën fjalën (apo) kjo fjalë për sistemin pesë vjeçar apo master, dhe vazhdon drejtimi automatike dhe elektroteknikë.

Sa i përket pretendimit të tjetër se operatori i shpallur fitues nga AK ka çmime jo normalishtë të ulta ky pretendim nuk qëndron për arsye se të gjitha ofertat e pranuar kanë laramani të çmimeve në pozicione të ndryshme dhe krahasuar me ofertën e tenderuesit ankues është më afër çmimeve të tregut.

Pretendimi : Dallimi i çmimeve që ky OE ka ofruar në krahasim me çmimet e tregut janë jashtëzakonisht i larta. Ky pretendim nuk qëndron sepse asnjë çmim nuk është më i lartë se çmimet e ofruara nga tenderuesi ankues.

Sa i përket pretendimit tjetër ne lidhje me Nenin 7- Barazia ne trajtim/Jo-Diskriminimi dhe transparenca, ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues perkatesishte komisioni i vleresimit konsideron se ka vepruar konforme kerkesave dhe deshmive te kerkuara ne baze te dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate per kete aktivitet te prokurimit, si dhe duke i'u permbajtur dispozitave ligjore te LPP-se. AK me kete rast konsideron se per kete aktivitet te prokurimit ka nxjerr vendim te drejt, te arsyeshem dhe meritor duke i'u permbajtur nenit 7, paragrafeve 1, 2 dhe 4 te LPP-se, i cili garanton trajtim te barabarte, jodiskriminues, transparente dhe konkurrues ne mes te Operatoreve Ekonomik.

Sa i përket pretendimit tjetër ne lidhje Neni 59 - Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, edhe ky pretendim nuk qëndron për arsye se Autoriteti Kontraktues ne baze te dispozitave ligjore te LPP-se perkatesishte nenit 59 ka kerkuar sqarime shtese me ane te letrës standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit nga te gjithë Operoret Ekonomik mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahasimi i tenderëve dhe duke ju përmbajtur dispozitave ligjore te LPP-se ne baze te neni 59 te ketij ligji.

Sa i përket pretendimit tjetër ne lidhje Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, pretendimi juaj nuk qëndron për arsye se AK ne baze te paragrafit 1.1 te këtij neni ka rekomanduar për kontrate OE me tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

AK, konsideron se tenderi juaj është vlerësuar me kujdes dhe ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP.

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi te ketij vendimi.

Bekim Shabani, Drejtor i drejtorisë së Prokurimit

